



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 22 Prot.

Gjirokastrë më, 07.01.2026

V E N D I M

Nr. 01, datë 07, 01, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2026, SIPAS FONDIT GRANT
TË MIRATUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË
LARTË (AKFAL)**

Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr. 111/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët të MAS dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të ndryshuar; Vendimit nr. 01, datë 05.01.2026, të Bordit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), "Për miratimin e përlllogaritjes së fondit të grantit të mësimdhënies për institucionet publike të arsimit të lartë, për periudhën buxhetore 2026–2028"; Shkresës së Administratorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nr. 14 prot., datë 06.01.2026, "Dërgohen propozime për detajimin e buxhetit për vitin 2026"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin e detajimit të buxhetit për vitin 2026, në kuadër të fondit grant të mësimdhënies të akorduar nga AKFAL, në vlerën totale 333.000.000 (treqind e tridhjetë e tre milionë) lekë, nga të cilat:
2. Ngarkohet Rektorati dhe Administratori i Universitetit për zbatimin e këtij vendimi, si dhe për përcjelljen e tij pranë Bordit të Administrimit për vijimin e procedurave përkatëse financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 156 Prot.

Gjirokastrë, më 30/01 2026

V E N D I M

Nr. 02, datë 30 . 01 . 2026

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 9, DATË 23.01.2025
MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE
DOKTORATË NË "EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE" PROGRAM I
PËRBASHKËT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" DHE UNIVERSITETIT
TË MAQEDONISË PERËNDIMORE -GREQI**

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 4/b e nenit 3, pika 1 e nenit 4, pika 1/a dhe pika 3 e nenit 38, pika 3 e nenit 69, pika 2 e neni 78, neni 135, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", pika 3 /j e nenit 19, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe propozimeve të Njesisë Kryesore të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe mbështetur në shkresën e MA –së. Nr. 8230 prot, datë 19.12.2025 "Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2026-2027"; Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 30. 01. 2026, :

V E N D O S I :

1. Të miratojë një shtesë në vendimin nr. 09, datë 23.01.2025.
2. Miraton kriteret e pranimit për pranimet në ciklin e tretë, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, për programin e përbashkët Doktoratë në "Edukim dhe Shkencat Humane"
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Zëvendës Rektori për procesin mësimor, Dekanët e njësive kryesore dhe Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i përcillet Ministrisë së Arsimit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe publikohen/ përditësohen në faqen zyrtare të universitetit dhe në portalin U-albania

NËN KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR GËZIM SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 224 Prot.

Gjirokastrë më, 10.02.2026

V E N D I M

Nr. 03, datë 10, 02, 2026

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ORGANIKËS SË PERSONELIT AKADEMIK TË
FAKULTETIT EKONOMIK

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 3, pika 1, neni 38, pika ç, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 7, Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit e Lartë" me propozim të Dekanatit të Fakultetit Ekonomik me shkresën nr.07 prot, datë 02.02.2026, Senatit Akademik i mbledhur sot në datë 10.02.2026:

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të organikës së personelit akademik të Fakultetit Ekonomik, duke reflektuar rritjen e ngarkesës mësimore për zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimit, sipas propozimit të paraqitur nga Dekanati.
2. Numri i përgjithshëm i organikës së personelit akademik të Fakultetit Ekonomik të rritet dhe të shkojë në 27 (njëzet e shtatë) pozicione.
3. Ky ndryshim të reflektohet në strukturën organike të Universitetit, si dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHORCANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 225 Prot.

Gjirokastër më, 10.02 2026

V E N D I M

Nr. 04, datë 10, 02, 2026

**PËR
E MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN PËR PUNËSIMIN DHE
PËRZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK DHE ATIJ ADMINISTRATIV NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të: neneve 33, pika 38, pika 1, gërma (d), neni 67, pika 2 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, nenit 19, pika 2, gërma (d) të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Rregullores së Përgjithshme të Universitetit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi; Në funksion të rritjes së transparencës, garantimit të funksionimit të brendshëm sipas parimeve të ligjshmërisë, llogaridhënies dhe efektivitetit administrativ e akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2026;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në Rregulloren e Punësimit dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrative në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, duke parashikuar që, përveç vlerësimit të kandidatëve mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në dosje, në procedurat e konkurrimit të përfshihet edhe intervista me gojë.
2. Intervista me gojë do të zhvillohet sipas procedurës së bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përbën pjesë integrale të tij.
3. Komisionet e vlerësimit ngarkohen me zbatimin e këtij ndryshimi në të gjitha procedurat e rekrutimit që shpallen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe në procedurat aktualisht në zhvillim, për aq sa fazat procedurale përkatëse nuk janë përmbyllur dhe janë parashikuar në aktet e shpalljes së konkurrimit.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore për reflektimin e ndryshimeve përkatëse në tekstin e konsoliduar të Rregullores së Punësimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Rregulloret miratohen si pjesë e akteve normative të universitetit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

**KRYETARI
PROF. DR JAHORANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 226 Prot.

Gjirokastrë më, 10.02.2026

V E N D I M

Nr. 05, datë 10.02, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË
PJESSHME DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
TË NATYRËS**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma ç, neni 57 e neni 62, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster neni 51, neni 52, referuar shkresës nr.12/1 prot, datë 29.01.2026 "Përcjellje e propozimeve për numrin e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar, semestri i dytë", Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 10.02.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar, semestri i dytë, në Njësinë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 2 (dy) personel akademik
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit, Administratori, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHORCANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 227 Prot.

Gjirokastrë më, 10.02.2026

V E N D I M

Nr. 06, datë 10, 02, 2026

P Ë R

MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE KOLEGJIT "TË
PSIKOLOGJISË SË APLIKUAR" REPUBLIKA ÇEKE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në
Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38,
Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në
mbledhjen e të datës 10.02.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe "Kolegjit të Psikologjisë së Aplikuar", Republika Çeke sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 297 Prot.

Gjirokastër më, 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 07, datë 19, 02, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2025, MIRATIMIN E
BUXHETIT TË DETAJUAR, AKORDUAR NGA SHTETI PËR VITIN 2026, DHE
REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 3, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Vendimit nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", neni 19, pika 2, Udhëzimit të përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit financiar të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkim shkencor", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 2, dhe shkresave të administratorit nr.287, datë 18.02.2026, nr.288, datë 18.02.2026 Senati Akademik mori në analizë draftin e paraqitur për detajimin e buxhetit të akorduar nga shteti për vitin 2026 dhe në mbeldhjen e datës 06.02.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, e raportit vjetor, përfundimtar të buxhetit për vitin 2025.
2. Miratimin, e buxhetit të detajuar, akorduar nga shteti për vitin 2026, dhe regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2026.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 298 Prot.

Gjirokastrë më, 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 08, datë 19, 02, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT TË
EKONOMISË -VARNA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 19.02.2026,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Universiteti i Ekonomisë – Varna i përfaqësuar nga Prof. Dr Evgeni Petrov Stanimirov sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 299 Prot.

Gjirokastrë më, 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 09, datë 19, 02, 2026

PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 1, neni 38, pika ç, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 7, Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit e Lartë", Vendimit të Rektoratit nr. 01, datë 19.02.2026, Senati Akademik i mbledhur sot më datë 19.02.2026 me propozim të Rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë,

VENDOSI :

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të Universitetit "Eqrem Çabej" dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 300 Prot.

Gjirokastrë më, 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 10, datë 19, 02, 2026

P Ë R

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, neni 38, pika 1, gërma ç, Udhëzimin nr. 27, datë 27.06.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të institucioneve publike të arsimit të lartë"; Dhe në zbatim të kompetencave të Senatit Akademik si organi më i lartë kolegjal akademik i institucionit të arsimit të lartë publik, në mbledhjen e datës 19.02.2026

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektstatutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dërgimin për miratimin e tij sipas tekstit bashkëlidhur te organet përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 301 Prot.

Gjirokastrë më, 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 11, datë 19, 02, 2026

P Ë R

**MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË REGJISTRIT TË ARRITJEVE AKADEMIKE PËR
KATEGORI TË VEÇANTA STUDENTËSH**

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, mbështetur në nenin 49 dhe nenin 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2019 "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave", Kreu III "Regjistri i arritjeve akademike", pika 8 dhe pika 9; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Propozimin e Kryesekretarit, përcejellë me shkresën nr. 64 Prot., datë 15.01.2026; Pasi shqyrtoi problematikat e konstatuara në lidhje me plotësimin e regjistrave të arritjeve akademike për studentët që regjistrohen me transferim studimesh, studentët që rifillojnë studimet dhe studentët përsëritës,

V E N D O S I:

1. Të përcaktojë mënyrën e plotësimit të regjistrit të arritjeve akademike për kategori të veçanta studentësh, me qëllim garantimin e rregullsisë dokumentare, vazhdimësisë numerike dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi si më poshtë:
 - Studentët që regjistrohen me transferim studimesh dhe pas procesit të ekuivalentimit të planit mësimor, regjistrohen në vit të dytë ose të tretë, të shkruhen në fund të listës së studentëve të vitit përkatës (viti i dytë ose i tretë), poshtë vijës së kuqe nqs ka përputhje plani mësimor, në të kundërt këta studentë të shkruhen në një faqe të re të regjistrit.
 - Studentët pajisen me numër të ri rendor, sipas radhës së regjistrimit në vitin akademik përkatës.
2. Studentët që rifillojnë studimet regjistrohen në vitin akademik përkatës aktual, në përputhje me vendimin e organit kompetent për rifillim studimesh.
 - Në rast se regjistri i arritjeve akademike për vitin përkatës është i mbyllur dhe nuk disponon hapësirë të lirë për shtim emrash, lihet një faqe bosh para regjistrimit të studentëve të rinj të vitit pasardhës.

- Në faqen bosh shënohet arsyeja e lënies bosh të faqes, duke evidentuar se ajo përdoret për regjistrimin e studentëve që rifillojnë studimet.
 - Këta studentë ruajnë numrin rendor të regjistrit që kanë pasur në vitin akademik në të cilin janë regjistruar fillimisht.
3. Studentët përsëritës që i nënshtrohen ndryshimeve të planit mësimor regjistrohen në fund të listës së studentëve të vitit përkatës (viti i parë, i dytë ose i tretë), në një faqe të re ose në hapësirën e disponueshme poshtë vijës së kuqe të mbylljes, nëse ekziston hapësirë e mjaftueshme.
 - Studentët përsëritës ruajnë numrin rendor të regjistrit me të cilin janë pajisur në vitin akademik të regjistrimit fillestar.
4. Ngarkohet Kryesekretari, si dhe sekretaritetë mësimore të njësive kryesore, për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Çdo regjistrim duhet të shoqërohet me referencë ndaj vendimit administrativ përkatës (transferim, rifillim, përsëritje), i cili arkivohet në dosjen individuale të studentit.
 6. Plotësimi i regjistrit duhet të respektojë integritetin e dokumentit, ndalimin e fshirjeve dhe korrektimeve të palejuara, si dhe vijimësinë numerike sipas Udhëzimit nr. 16, datë 08.07.2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet për vitin akademik 2025–2026 dhe në vijim.

KRYETARI
PROF. DR. JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 524 Prot.

Gjirokastrë më, 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 12, datë 25, 03, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PËRBËRJES SË BORDIT EDITORIAL TË BULETINIT SHKENCOR
"KËRKIME UNIVERSITARE" NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40, pika 4, të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, të Rregullores së Buletinit Shkencor "Kërkime Universitare" nr. 1463/1 prot, datë 02.12.2021, neni 7, si dhe mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore: Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me nr. 08, datë 23.12.2024 dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës me nr. 01, datë 24.02.2026, Fakulteti Ekonomik nr.02. datë 03.03.2026 si dhe Vendimit nr. 05, datë 17.03.2026 të Rektoratit, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e datës 25.03.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë përbërjen e Bordit Editorial të Buletinit Shkencor "Kërkime Universitare", si më poshtë:

a) Kryetari i Bordit Editorial

Prof. dr. Jaho Cana, Rektor i UGJ-së;

b) Anëtarë të Bordit Editorial

Prof. asoc. Merita Isaraj;

c) Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe të Edukimit

Prof. dr. Gëzim Sala;

Prof. dr. Shyqyri Hysi;

Prof. asoc. Valbona Duri;

Prof. asoc. Merita Shehu

Prof. asoc. Joana Taçi

ç) Seksioni i Shkencave të Natyrës

Prof. asoc. Sadik Malo;
Prof. dr. Lavdi Hasani;
Prof. asoc. Kastriot Zoto;
Prof. asoc. Maria Agolli;

d) Seksioni i Shkencave Ekonomike

Dr. Robert Çelo;
Dr. Zamira Veizi;
Prof. as. Drita Luzo;
Prof. as. Enkela Caca.

2. Bordi Editorial organizohet dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Rregulloren e Buletinit Shkencor “Kërkime Universitare”, duke përfshirë koordinimin e procesit të botimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e punimeve shkencore, si dhe garantimin e standardeve akademike dhe shkencore të botimit.
3. Ngarkohet Zëvendësrektori për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, si dhe për monitorimin e veprimtarisë së Bordit Editorial.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim strukturave përkatëse.

**KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 525 Prot.

Gjirokastrë më, 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 13, datë 25.03, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR", CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR DHE
PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO -
PEDAGOGJIKE PËR VITIN AKADEMIK 2026 - 2027**

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69, pika 3, Statutit të UGJ-së, neni 62 pika 4, referuar niveleve 5-6-7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve neni 81, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe çertifikohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në Vendimin nr.05, datë 05.03.2026 "Për miratimin e kuotave të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore", Vendimit nr. 01, datë 03.03.2026 të Fakultetit Ekonomik dhe Vendimit nr. 02, datë 02.03.2026, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës; shkresës përcjellëse të Drejtorisë së Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar nr.375/1 prot, datë 18.03.2026 në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Të miratojë kuotat e pranimi të studentëve për vitin akademik 2026 -2027, për programet e ciklit të parë, ciklit të dytë, ciklit të tretë të studimeve, programeve me karakter profesional 2 - vjeçar dhe programit të formimit të vazhduar në fushën psiko - pedagogjike sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për miratimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 526 Prot.

Gjirokastrë më 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 14, datë 25.03.2026

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE ZYRËS SË
KOMISIONERIT TË LARTË TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REFUGJATËT
(UNHCR), PËRMES ZYRËS SË SAJ NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR), përfaqësuar nga Toshitsuki Kaçauchi përmes zyrës së saj në Shqipëri sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR. DAHO ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 527 Prot.

Gjirokastrë më, 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 15, datë 25, 03, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE LIGËS SË
UNIVERSITETEVE NGA RAJONI I FORUMIT EKONOMIK TË VJENËS "NGA
ADRIATIKU NE DETIN E ZI"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Ligës së Universiteteve nga Rajoni i Forumit Ekonomik të Vjenës "Nga Adriatiku në Detin e Zi" përfaqësuar nga Amb.Dr Emil Brix President dhe Amb.Dr. Elena Kirtcheva sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR. JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 528 Prot.

Gjirokastrë më, 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 16, datë 25, 03, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE KOLEGJIT
UNIVERSITAR PËR EDUKIMIN E MËSUESVE AUSTRIA E POSHTME**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Kolegjit Universitar për Edukimin e Mësuesve Austria e Poshtme përfaqësuar nga Dr. Senad Bećirović sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR. JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 529 Prot.

Gjirokastrë më 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 17, datë 25, 03, 2026

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE QËNDRËS SË
STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët e përfaqësuar nga Prof. Asoc Diana Kastrati sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 533 Prot.

Gjirokastrë më, 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 18, datë 25, 03, 2026

P Ë R

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, neni 38, pika 1, gërma ç, Udhëzimin nr. 27, datë 27.06.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të institucioneve publike të arsimit të lartë"; Dhe në zbatim të kompetencave të Senatit Akademik si organi më i lartë kolegjal akademik i institucionit të arsimit të lartë publik, në mbledhjen e datës 19.02.2026

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektstatutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dërgimin për miratimin e tij sipas tekstit bashkëlidhur te organet përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 622 Prot.

Gjirokastrë më, 08.04 .2026

V E N D I M

Nr. 19 , datë 08 , 04 , 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR PLOTËSIMIN E FAZËS SË DYTË TË
PROCEDURËSS SË APLIKIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT
(DIPLOMË E DYFISHTË)**

"BACHELOR NË INFERMIERISTIKË"

**MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE UNIVERSITETIT
TË PIEMONTE, ITALI**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 73 e neni 80; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar"; VKM nr. 823, datë 28.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41/2018"; Udhezimit nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; Rregullores së brendshme të UGJ-së; si dhe mbështetur në Vendimin nr. 5, datë 30.10.2025 të Njesisë Bazë të Infermierisë për miratimin e hapjes së programit të ri të përbashkët (diplomë e dyfishtë) "Bachelor në Infermieristikë", Shkresën e Njesisë Bazë të Infermierisë nr. 144/2, datë 03.11.2025, me propozimin për hapjen e programit të ri dhe dokumentacionin përkatës, Vendimin nr. 06, datë 18.11.2025 të Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për miratimin e hapjes së programit të përbashkët dhe planit mësimor, Shkresën përcjellëse të Fakultetit nr. 153 Prot., datë 18.11.2025, për Rektorin e Universitetit, Propozimin për kodifikimin e programit të ri me kodin **63BA0913SAI**, referuar shkresës së Njesisë Bazë të Infermierisë datë 30.10.2025, Dokumentacionin shoqërues të fazës së parë, të përgatitur sipas udhëzimit nr. 1/2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe shkresës nr. 2472 prot, datë 30.03.2026 te MA dhe shkresës nr.2742/2 prot, datë 08.04.2026 të MA në mbledhjen e datës 08.04.2026,

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin për plotësimin e fazës së dytë të procedurës së aplikimit për hapjen e programit të përbashkët (diplomë e dyfishtë) "Bachelor në Infermieristikë", ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Universitetit të Piemontes, Itali, sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Të miratojë hedhjen e dokumentacionit të plotë pranë e-albania, për vijimin e procedurave të mëtejshme për hapjen e programit të studimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar dhe Standardeve Akademike, të finalizoj procesin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHOR ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 764 Prot.

Gjirokastrë më, 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 20, datë 30, 04, 2026

P Ë R

**AKORDIMIN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" PËR PROF. DR AGO
NEZHA NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 3, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 19, pika 9, në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, me propozimin e Kryetarit të Senatit Akademik me shkresën Nr.522 Prot., datë 25.03.2026 dhe me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit, shkresa me Nr. 2828/2 Prot., datë 15.04.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.04.2026,

V E N D O S I :

1. T'i akordojë titullin "Doctor Honoris Causa" për Prof. Dr Ago Nezha.

Për kontribut të shquar në fushën e publicistikës, kulturës dhe dokumentimit të vlerave të trashëgimisë shqiptare, për veprimtari të pasur krijuese e studimore, si dhe për angazhimin e tij të vazhdueshëm në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor e kombëtar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHORIANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr. 765 Prot.

Gjirokastër më, 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 21 , datë 30 , 04 , 2026

P Ë R

**AKORDIMIN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" PËR AKADEMIK
PËLLUMB ZHUFËI NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 3, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 9, në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, me e Kryetarit të Senatit Akademik me shkresën Nr.521 Prot., datë 25.03.2026 dhe me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit, shkresa me Nr.2828/2 Prot., datë 15.04.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.04.2026,

V E N D O S I :

2. T'i akordojë titullin "Doctor Honoris Causa" për Akademik Pëllumb Xhufi.

Për kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e historisë, për veprimtari të spikatur akademike, kërkimore dhe botuese, si dhe për ndikimin e qëndrueshëm në studimet mesjetare dhe në pasurimin e mendimit historiografik shqiptar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

**K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 766 Prot.

Gjirokastrë më, 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 22, datë 30.04.2026

P Ë R

RIORGANIZIMIN E PJESSHËMË TË PLANEVE MËSIMORE DHE KURRIKULËS SË TYRË PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027 DERI NË MASËN 20 % NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE DHE FAKULTETIN EKONOMIK

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma f, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma i, Rregullores së Brendshme të Universitetit, neni 36, pika 4, Vkm-së nr.185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 18.12.2018 mbështetur në vendimin e Drejtuesit të Njësisë Kryesore në Fakultetin Ekonomik me nr. 03, datë 14.04.2026 "Për riorganizimin deri në masën 20 % të planeve mësimore të ofruara nga Fakulteti Ekonomik", si dhe Vendimit nr. 06 prot, datë 29.04.2026 të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore "Për miratimin e riorganizimit të planit mësimor të programit të Ciklit të Parë të Studimeve bachelor ne Gjuhë, Letërsi Shqipe me kohë të plotë, për vitin akademik 2026-2027", si dhe pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga njësitë kryesore dhe të analizuara,

VENDOSI:

1. Të miratohet riorganizimi i pjesshëm të planeve mësimore dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2026-2027 deri në masën 20 % në programet e studimit universitare (profesional, bachelor, master), sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me Vendimin nr.06, datë 29.04.2026 protokolluar me nr.104, datë 29.04.2026.
2. Të miratohet riorganizimi i pjesshëm të planeve mësimore dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2026-2027 deri në masën 20 % në programet e studimit universitare (profesional, bachelor, master), sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti Ekonomik me Vendimin nr.03, datë 14.04.2026 protokolluar me nr.34, datë 14.04.2026.
3. Zbatimi i këtij vendimi do të fillojë me hyrjen në fuqi të vitit akademik 2026-2027.
4. Ngarkohen, Drejtoria e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me afatet dhe udhëzimet ligjore në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHŪ ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 767 Prot.

Gjirokastrë më, 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 23 , datë 30 , 04 , 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR AKREDITIM TË
PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 3, 14 dhe 38, akteve nënligjore në fuqi për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë; Statutit dhe rregulloreve të brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Kërkesës me nr. 755 prot., date 29.04.2026, për fillimin e procedurës së aplikimit për akreditim të programeve të studimit; Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 30.04 2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë fillimin e procedurës së aplikimit për akreditim pranë ASCAL për programet e studimit si më poshtë:

Diplomë Profesionale:

- Asistent Administrativ
- Ndihmës Ekonomist
- Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike
- Edukatorë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)
- Udhërrëfyes Turistik
- Librar dhe Bibliotekar

Bachelor:

- Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm
- Menaxhim Digjital
- Mësuesi për Arsimin Fillor

Master Profesional:

- Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke
- Mësuesi në Arsimin Fillor

Master i Shkencave:

- Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike
- Mësuesi në Biologji-Kimi
- Mësuesi në Gjuhë Angleze
- Mësuesi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
- Mësuesi në Matematikë – TIK
- Mësuesi në Histori-Gjeografi
- Mësuesi në Matematikë Fizikë

Master:

- Mësuesi për AMU në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek

Doktoratë:

- Edukim dhe Shkenca Humane

2. Të autorizojë Drejtorinë e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik dhe Ndërkombëtar për koordinimin institucional të procesit dhe për depozitimin e dokumentacionit përkatës pranë ASCAL.

3. Të ngarkojë njësitë bazë dhe fakultetet përkatëse për sigurimin e përputhshmërisë së programeve me kuadrin ligjor dhe standardet e cilësisë dhe vënien në dispozicion të të gjitha evidencave akademike dhe administrative të kërkuara.

4. Të ngarkojë Administratori i Universitetit për sigurimin e mbështetjes financiare dhe logjistike për zhvillimin e procesit të akreditimit.

5. Të gjitha strukturat e Universitetit janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të respektojnë afatet dhe kërkesat që rrjedhin nga procesi i akreditimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim të gjitha strukturave përkatëse.

**KRYETARI
PROF. DR JAHO CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 857 Prot.

Gjirokastrë më, 13.05.2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 13, 05, 2026

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLORES SË MOBILITETIT NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në neni 38, pika 1, gërma (d) të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 19, pika 3, gërma (d) të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Rregulloren e Brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Urdhrin e Rektorit nr. 152, datë 20.10.2025 "Për ndryshimin e përbërjes së Komisionit 'ad hoc' për përgatitjen e projekt-rregullore të mobilitetit në Universitetin 'Eqrem Çabej' Gjirokastrë"; si dhe shkresën përcjellëse të Komisionit "ad hoc" për paraqitjen për miratim të projekt-rregullore të mobilitetit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.05.2026;

V E N D O S I:

1. Të miratojë "Rregulloren e Mobilitetit në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Rregullorja ka për qëllim rregullimin dhe standardizimin e procedurave të mobilitetit akademik dhe administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat institucionale të ndërkombëtarizimit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektorati, njësitë kryesore dhe bazë, si dhe strukturat administrative përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mobilitetin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Rregullorja miratohet si pjesë e akteve normative të universitetit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 858 Prot.

Gjirokastër më, 13.05.2026

V E N D I M

Nr. 25, datë 13, 05, 2026

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN DHE
PËRDORIMIN E FAQES ZYRTARE TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 1, gërma (d); Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; Ligjin nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike"; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Urdhrin e Rektorit për ngritjen e komisionit për hartimin e rregullores për administrimin dhe përdorimin e faqes zyrtare www.uogj.edu.al; si dhe shkresën përcjellëse të komisionit për paraqitjen për miratim të projekt-rregullores, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.05.2026

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren "Për administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e faqes zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e kuadrit normativ dhe organizativ për administrimin, menaxhimin, publikimin dhe përditësimin e informacionit në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektorati, njësitë kryesore dhe bazë, strukturat administrative, si dhe personat përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të Universitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Rregullorja miratohet si pjesë e akteve normative të universitetit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI

PROF. DR JAHORANA





Bresi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 860 Prot.

Gjirokastrë më, 13.05.2026

V E N D I M

Nr. 26, datë 13.05.2026

P Ë R

MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË ZGJEDHJEVE JASHTË RADHE
PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË TË POLITIKAVE EKONOMIKE DHE
TURIZMIT

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 38, nenin 39 dhe nenin 42 pika 9; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, Rregulloren e MAS nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë"; si dhe Urdhrin e Rektorit nr.70, datë 11.05.2026 "Për fillimin e procedurës së zgjedhjeve jashtë radhe për drejtues të njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit", Senatit Akademik i mbledhur sot më datë 13.05.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë fillimin e procedurës së zgjedhjeve jashtë radhe për pozicionin e drejtuesit të njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Të miratojë plotësimin e vakancës së Sekretarit të KIZ me zj. Griselda Shehu.
3. Të miratojë plotësimin e vakancës së përfaqësuesit të studentëve në KIZ me zj. Angjeliqi Agora.

4. Të miratojë datën 12.06.2026 për zhvillimin e zgjedhjeve jashtë radhe për drejtues të njësive bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.
5. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) të ndjekë dhe administrojë procesin zgjedhor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.
6. Administrata e Universitetit dhe strukturat përkatëse të Fakultetit Ekonomik të krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit zgjedhor.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 936 Prot.

Gjirokastrë më 25.05.2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 25.05.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË ZGJEDHJEVE JASHTË RADHE
PËR DREJTUES NJËSISË BAZË TË SHKENCAVE BIOLOGJIKE, MJEDISORE DHE
USHQIMIT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 38, nenin 39 dhe nenin 42 pika 9; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, Rregulloren e MAS nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë"; si dhe Urdhrin e Rectorit nr.73, datë 22.05.2026 "Për fillimin e procedurës së zgjedhjeve jashtë radhe për drejtues të njësive bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës", Senatit Akademik i mbledhur sot më datë 25.05.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë fillimin e procedurës së zgjedhjeve jashtë radhe për pozicionin e drejtuesit të njësive bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Të miratojë datën 26.06.2026 për zhvillimin e zgjedhjeve jashtë radhe për drejtues të njësive bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës
3. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) të ndjekë dhe administrojë procesin zgjedhor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
4. Administrata e Universitetit dhe strukturat përkatëse të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit zgjedhor.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHORIANA





Bredur

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1059 Prot.

Gjirokastrë më, 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 29, datë 17.06.2026

P Ë R

MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT DERI NË MASËN 20% TË PËRMBAJTJES SË SHPREHUR NË KREDITE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR "MËSUESI NË ARSIMIN FILLOR", "MËSUESI PËR ARSIM PARASHKOLLOR" DHE PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL "MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma f, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma i, Rregullores së Brendshme të Universitetit, neni 36, pika 4, Vkm-së nr.185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 18.12.2018 mbështetur në vendimin e Drejtuesit të Njësisë Kryesore në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me nr. 07, datë 06.05.2026 "Për riorganizimin deri në masën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite të programeve të studimit", përcjellë me shkresën nr. 118 prot., datë 06.05.2026", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e datës 17.06.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin përfundimtar të riorganizimit deri në masën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite të planit mësimor të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor "Mësuesi në Arsimin Fillor", sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me Vendimin nr.07, datë 06.05.2026.
2. Miratimin përfundimtar të riorganizimit deri në masën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite të planit mësimor të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor "Mësuesi për Arsim Parashkollor", sipas strukturës së paraqitur nga Vendimin nr.07, datë 06.05.2026.
3. Miratimin përfundimtar të riorganizimit deri në masën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite të planit mësimor të programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional "Mësues në Arsimin Special", sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me Vendimin nr.07, datë 06.05.2026.
4. Zbatimi i këtij vendimi do të fillojë me hyrjen në fuqi të vitit akademik 2026–2027.

5. Ngarkohen, Drejtoria e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me afatet dhe udhëzimet ligjore në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

**KRYETARI
PROF. DR. JAHO ÇANA**





Borç

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1060 Prot.

Gjirokastër më, 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 29, datë 17, 06, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË TRETË
TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË "EKONOMI DHE INOVACION", NË
BASHKËPUNIM MIDIS FAKULTETIT EKONOMIK TË UNIVERSITETIT "EQREM
ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE DHE
HUMANE TË UNIVERSITETIT DAUGAVPILS – LETONI**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 77, pika 2 dhe 4, neni 78, neni 79, neni 80 dhe neni 88; VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 01, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar, Kreu IV/E "Kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit Doktoratë"; duke marrë në shqyrtim propozimin e grupimit të njësive bazë të Fakultetit Ekonomik, Vendimin e Dekanatit të Fakultetit Ekonomik nr. 06, datë 05.06.2026, si dhe dokumentacionin shoqërues për hapjen e programit të përbashkët të studimeve të doktoratës, Senati Akademik ne mbledhjen e datës 17.06.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Inovacion", referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohë të plotë, pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Humane të Universitetit Daugavpils – Letoni.
2. Programi i përbashkët i doktoratës organizohet dhe funksionon në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërinstitucional midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetit Daugavpils – Letoni, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Kohëzgjatja e programit të studimeve është jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.
4. Në përfundim të programit të përbashkët të studimeve të doktoratës, lëshohet diploma e përbashkët e gradës shkencore “Doktor”, nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Universiteti Daugavpils – Letoni, e ofruar në gjuhën angleze.
5. Ngarkohet Fakulteti Ekonomik dhe strukturat përgjegjëse të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për përcjelljen e dokumentacionit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucioneve të tjera kompetente.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
PROF. DR. JAHO ÇANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1061 Prot.

Gjirokastrë më, 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 30, datë 17, 06, 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE PËR MENAXHER MJEDISI", NË
BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN DAUGAVPILS – LETONI**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 75 pika 3 dhe nenit 80; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit", i përditësuar; Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej", Mbështetur në Vendimin nr. 07, datë 15.06.2026 të Departamentit të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, Vendimin nr. 04, datë 15.06.2026 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhe shkresën nr. 87 prot., datë 15.06.2026 të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me objekt "Propozim për hapjen e programit të përbashkët të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave për Menaxher Mjedisori", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e datës 17.06.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave për Menaxher Mjedisori", në bashkëpunim ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Universitetit Daugavpils – Letoni.
2. Programi i studimit do të ofrohet me kohë të plotë, pranë Njesisë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dhe i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
3. Miratimin e planit mësimor të programit të përbashkët, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me një total prej 120 ECTS, si dhe ofrimin e këtij programi në gjuhën shqipe dhe angleze.
4. Miratimin e dokumentacionit të fazës së parë të aplikimit për hapjen e këtij programi studimi, sipas kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

5. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe strukturat përgjegjëse të Universitetit “Eqrem Çabej” për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për hapjen e programit pranë institucioneve përgjegjëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA





Brese.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1068 Prot.

Gjirokastrë më, 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 31, datë 17, 06, 2026

P Ë R

**RIORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 38 dhe nenit 103, Vendim i KM nr. 990, datë 09.12.2015, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 424, datë 02.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar, Vendim Nr. 628, datë 10.10.2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Rregullores për organizimin dhe punën e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë miratuar me VSA nr.26, datë 08.09.2020 si dhe në kuadër të forcimit të mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe vijimit të procesit të vlerësimit të jashtëm institucional nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Vendimit të Senatit Akademik nr.38, datë 09.12.2020 "Për ngritjen e NJSBC në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2026,

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, si strukturë përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe zhvillimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucion.
2. Të miratojë përbërjen e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, prej 7 (shtatë) anëtarësh, si më poshtë:
 - Prof. Dr Gëzim Sala – Kryetar përfaqësues i Rektoratit.
 - Prof. Asoc Albina Sinani – anëtar, përfaqësues i personelit akademik pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - Dr. Zhenisa Çuni – anëtar, përfaqësues i personelit akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës;

- Dr. Arjola Mitaj – anëtar, përfaqësues i personelit akademik pranë Fakultetit Ekonomik;
 - Znj. Klavira Dudumi – anëtar, përfaqësues i personelit ndihmës akademik administrativ, Koordinator INST.
 - Znj. Borana Lelaj – anëtar, përfaqësues i personelit ndihmës akademik administrativ;
 - Znj. Gligor Koça – anëtar, përfaqësues i studentëve.
3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të Universitetit, duke pasur si detyra kryesore:
- a) zhvillimin dhe koordinimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitet;
 - b) ndjekjen e proceseve të vetëvlerësimit institucional dhe të programeve të studimit;
 - c) mbështetjen dhe koordinimin e proceseve të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit;
 - d) mbledhjen, analizimin dhe administrimin e të dhënave në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë;
 - e) bashkëpunimin me njësitë kryesore, njësitë bazë dhe strukturat administrative për zbatimin e standardeve të cilësisë;
 - f) përgatitjen e raporteve dhe dokumentacionit të kërkuar në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë.
4. Njësitë kryesore dhe strukturat përkatëse të Universitetit marrin masa për bashkëpunimin dhe vendosjen në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm për funksionimin e NJSBC-së.
5. Urdhëri nr.50, datë 14.05.2019 “Për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin ‘Eqrem Çabej’, Gjirokastrë” shfuqizohet.
6. Ngarkohen Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, njësitë kryesore dhe strukturat administrative për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1210 Prot.

Gjirokastrë më, 08.07.2026

V E N D I M

Nr. 32, datë 08.07.2026

P Ë R

**MBYLLJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE" NË "ARKEOLOGJI DHE ADMINISTRIM I
PASURIVE KULTURORE (ASPIC)"**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV, neni 35, pika 7 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar, Kreu IV/C "Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit", "Procedurat për mbylljen e programeve të studimit"; Urdhrin nr. 450, datë 14.08.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, për hapjen e programit të përbashkët të studimit "Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)"; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej"; Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 23, pika c; Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, neni 18, pika 6, germa "j"; Propozimin e Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë "Për mbylljen e programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)", datë 02.06.2026; Vendimin nr. 06, datë 02.06.2026, të Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë "Për mbylljen e programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)"; Dokumentin "Argumentim i mbylljes së programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)", datë 02.06.2026; Dokumentin "Argumentim për pasojat juridike të mbylljes së programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)", datë 02.06.2026; Shtojcën nr. 1 bashkëlidhur Vendimit nr. 06, datë 02.06.2026; Vendimin nr. 08, datë 18.06.2026, të Dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore "Për mbylljen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)".

VENDOSI:

1. Të miratojë mbylljen e programit të përbashkët të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore (ASPIC)".
2. Ky vendim t'i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me Kreun IV/C, pika 1, germa "a", të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar.
3. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, dokumentacioni i plotë t'i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet platformës e-Albania, për vijimin e procedurave të mbylljes së programit të studimit.
4. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, dokumentacioni i plotë t'i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet platformës e-Albania, për vijimin e procedurave të mbylljes së programit të studimit. Ngarkohen Bordi i Administrimit, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Njësia Bazë e Gjuhës. Letërsisë dhe Qytetërimit Grek Drejtoria e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar dhe Sekretaria Mësimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇABA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1211 Prot.

Gjirokastrë më, 08.07.2026

V E N D I M

Nr. 33, datë 08.07.2026

P Ë R

**MBYLLJEN E PROGRAMIT "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN
FILLOR NË GJUHËN GREKE"**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV, neni 35, pika 7 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i përditësuar, Kreu IV/C "Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit", "Procedurat për mbylljen e programeve të studimit"; Urdhrin nr. 690, datë 15.10.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për hapjen e programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke"; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej"; Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 23, pika c; Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, neni 18, pika 6, germa "j"; Propozimin e Njesisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek "Për mbylljen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke", datë 19.05.2026; Vendimin nr. 5, datë 19.05.2026, të Njesisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek "Për mbylljen e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke"; Dokumentin "Argumentim i mbylljes së programit të studimit në ciklin e dytë Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke", datë 19.05.2026; Dokumentin "Argumentim për pasojat juridike për mbylljen e programit të studimit në ciklin e dytë Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke", datë 19.05.2026; Shtojcën nr. 1 bashkëlidhur Vendimit nr. 5, datë 19.05.2026; Vendimin nr. 09, datë 18.06.2026, të Dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore "Për mbylljen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke".

V E N D O S I:

1. Të miratojë mbylljen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke".
2. Ky vendim t'i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me Kreun IV/C, pika 1, germa "a", të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar.
3. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, dokumentacioni i plotë t'i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet platformës e-Albania, për vijimin e procedurave të mbylljes së programit të studimit. Ngarkohen Bordi i Administrimit, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Njësia Bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek Drejtoria e Kurrikulave, Çështjeve Juridike dhe Zhvillimit Akademik e Ndërkombëtar dhe Sekretaria Mësimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA

